

CHARACTERISTICS OF GREEK SCIENTIFIC TERMINOLOGY

Antela Voulis

Academy of Albanological Studies, Tirana, Albania, antelavoulis@yahoo.com

Abstract: Not all science fields have the same terminology requirements. Each field has its own specific needs. In areas such as mathematics, physics and logic, satisfactory solutions to the problem of heavy terminologies have been found in the partial or almost exclusive use of word symbols. For a while vitamins have been identified by letter and number. But lately the tendency is to use words. Requirements in concrete sciences dealing with material things are not the same as abstract sciences. Sometimes specialties within the same field have different requirements. In the field of biology an important nomenclature problem has been to obtain a genus-type terminology that would distinguish and classify animals and plants. In medicine, on the other hand, the problem of classification has been less important than that of describing causes, processes, procedures, and effects. In chemistry, as in biology, the main function of terminology is to differentiate species, whereas in dentistry it is to attach meaningful and correct terms describing concepts, anomalies, and processes. However, most branches of the biological and medical sciences, despite some differences in their particular requirements, have the same terminology requirements. A good scientific term should not be merely an arbitrary label, but should suggest as clearly and as fully as possible the characteristics of the concept or object to which it is applied. It can rarely fully describe a descriptive term a structure, anomaly, process, function, or effect, but it can generally provide an accurate outline or brief description. The description should be as accurate as possible, suggesting the essential characteristic that distinguishes the concept in which the word is applied from all other concepts. It should not suggest irrelevant or uncertain details. If, for example, the cause of a pathological condition is not known, the term used to describe that condition should not seek to make any etiological determination.

Keywords: Greek language, science, terminology.

KARAKTERISIKA TË TERMINOLOGJISË SHKENCORE GREKE

Antela Voulis

Akademia e Studimeve Albanologjike, Tirana, Shqipëri, antelavoulis@yahoo.com

Abstrakt: Jo të gjitha fushat shkencore kanë të njëjta kërkesa për terminologjinë. Çdo fushë ka nevojat e veta të veçanta. Në fusha të tilla si matematika, fizika dhe logjika, zgjidhjet e kënaqshme për problemin e terminologjive të rënda janë gjetur në përdorimin e pjesshëm ose pothuajse ekskluziv të simboleve të fjalëve. Për një kohë vitaminat janë identifikuar me shkronjë dhe numër. Por kohët e fundit tendenca është që të përdorin fjalë. Kërkesat në shkencat konkrete që merren me gjërat materiale nuk janë të njëjta me ato të shkencave abstrakte. Ndonjëherë specialitetet brenda së njëjtës fushë kanë kërkesa të ndryshme. Në fushën e biologjisë një problem i rëndësishëm nomenklature ka qenë të marrim një terminologji gjini-lloj që do të dallonte dhe klasifikonte kafshët dhe bimët. Në mjekësi, nga ana tjetër, problemi i klasifikimit ka qenë më pak i rëndësishëm sesa ai i përshkrimit të shkaqeve, proceseve, procedurave dhe efekteve. Në kimi, ashtu si në biologji, funksioni kryesor i terminologjisë është të diferencohen llojet, ndërsa në stomatologji është të bashkëngjiten terma kuptimplotë dhe korrektë përshkrues të koncepteve, anomalive dhe proceseve. Megjithatë, shumica e degëve të shkencave biologjike dhe mjekësore, pavarësisht disa dallimeve në kërkesat e tyre të veçanta, kanë të njëjtat kërkesa për terminologjinë. Një term i mirë shkencor nuk duhet të jetë thjesht një etiketë arbitrare, por duhet të sugjerojë sa më qartë dhe sa më plotësisht të jetë e mundur karakteristikat e konceptit ose sendit në të cilin zbatohet. Rrallë mund të përshkruajë plotësisht një term përshkrues një strukturë, anomali, proces, funksion ose efekt, por në përgjithësi mund të sigurojë një skicë të saktë ose një përshkrim të shkurtër. Përshkrimi duhet të jetë sa më i saktë që të jetë e mundur, duke sugjeruar karakteristikën thelbësore që dallon konceptin në të cilin fjala zbatohet nga të gjitha konceptet e tjera. Nuk duhet të sugjerojë detaje të parëndësishme ose të pasigurta. Nëse, për shembull, shkaku i një gjendjeje patologjike nuk dihet, termi që përdoret për të përshkruar atë gjendje nuk duhet të kërkojë të bëjë ndonjë përcaktim etiologjik.

Fjalë çelës: gjuha greke, shkencë, terminologji.

Sipas gjuhëtarit grek J. Babinioti, “Gjuha greke nuk është thjesht një nga rreth 2700 gjuhët që flasin njerëzit sot në tokë. Greqishtja është - dhe kjo dihet tashmë - një gjuhë e veçantë, historike dhe kulturore në botën e gjuhëve. Njëpërmjet qytetërimit grek, të shprehur natyrisht me gjuhën dhe fjalët greke, ndodh që çdo njeri disi i arsimuar kudo

në tokë të ketë dëgjuar për këtë gjuhë. Veçanërisht folësit e gjuhëve evropiane, e dinë mirë se shumë fjalë të gjuhëve të tyre e kanë prejardhjen nga greqishtja. Kjo shpjegon se prestigji komunikues dhe kulturor i kësaj gjuhe, joproportional me shtrirjen ekonomike dhe gjeografike dhe praninë e Greqisë, është shumë i lartë”. Të gjitha artet dhe shkencat kanë marrë nga leksiku i gjuhës greke. Shumë gjuhë, si të lashta dhe moderne, kanë kontribuar në gjuhët ndërkombëtare me fjalë e terma që i përdorim edhe sot, por asnjë gjuhë nuk i ka furnizuar gjuhët e botës aq shumë sa greqishtja. Kështu, shumica e fjalëve teknike të përdorura në mjekësi e kanë origjinën nga greqishtja. Mbi dy të tretat e anglishtes së sotme mjekësore rrjedh vetëm nga greqishtja. Anglosaksonishtja, për shembull, nga e cila rrjedh përafërsisht një e treta e fjalëve të anglishtes së zakonshme, përbën 5 për qind të fjalëve në një fjalor mjekësor. Burimi tradicional i emrave të bimëve dhe kafshëve është nga greqishtja dhe latinishtja. Sa më teknike dhe të specializuara të jenë termat, aq më e lartë është përqindja e termave që e kanë origjinën nga greqishtja dhe latinishtja, sidomos nga greqishtja. Këto dy gjuhë të lashta formojnë bazën kryesore gjuhësore të terminologjisë shkencore moderne. Terminologjia shkencore gjer në kohët tona jo vetëm që është ndërtuar në një shkallë të gjerë nga elementët e fjalëve nga greqishtja dhe latinishtja, por këto të ashtuquajtura “gjuhë të vdekura” vazhdojnë t’i furnizojnë edhe sot fjalorët me terma të rinj. Termat e rinj të krijuar, që nevojiten nga zhvillimi i shpejtë i disa fushave shkencore, e kanë origjinën kryesisht nga gjuha greke.

Gjuhët e matin kapitalin leksikor me fjalët e tyre dhe e pasurojnë këtë kapital duke shtuar fjalë të reja. Pasurimi leksikor bëhet nëpërmjet krijimit të fjalëve të reja dhe herë me huazime e përshtatje fjalësh nga gjuhë të tjera, duke i përshtatur ato në sistemin e tyre fonologjik. Në pamje të parë, shumë fjalë nuk duken se janë me origjinë nga greqishtja, sepse kanë hyrë në gjuhën përkatëse shumë herët me rrënjë të greqishtes së vjetër dhe janë përshtatur shumë mirë në gjuhën ku kanë hyrë. Por analiza leksikore, etimologjike dhe historike e çdo fjale zbulon origjinën greke të saj. Ndonjëherë fjalët truallësore greke janë kthyer në greqishte si fjalë të huaja. Për shembull në anglishte fjalët *tur*, *turizëm* (*gr.* *τουρ*, *τουρισμός*) janë me origjinë nga greqishtja e vjetër (*gr. e vjet.* *τόρνος*), që ka kuptimin *cikël*. Po ashtu edhe emrat e disa shteteve si Italia, Egjipti, Etiopia, Spanja etj., janë me origjinë nga greqishtja. Jo vetëm leksiku grek por edhe mitologjia dhe historia greke i kanë pasuruar gjuhët evropiane dhe perëndimore me terma dhe kuptime.

Përpjekja për t’iu referuar shumë karakteristikave do të rezultojë ose në fjalë të vështira ose në kushte të cilat në një kohë të shkurtër mund të jenë të papërshtatshme për sendin e përmendur. Nomenklatura përkrahuese më e zhvilluar në shkencë është ajo që përdoret në kimi dhe në farmakologji. Edhe pa ndonjë njohuri të mëparshme në lidhje me një përbërje të caktuar, një kimist, duke vëzhguar emrin e një përbërjeje, mund të shkruajë formulën e saj kimike. Por emrat nuk kanë përmbajtje, ekonomi dhe komoditet dhe janë të vështirë të shprehen, dhe në njohje të këtyre mangësive, përdoren shkurtime ose emra pronësie: bulesin, kortizon, dhe butethaminë. *Sulfat* për *sulfanilamid* është një tjetër shembull i shkurtimeve të tillë. Kështu emrat e shkurtuar janë më pak përkrahuese sesa emrat e gjatë, por ato fitojnë shumë në ekonomi, komoditet dhe në lehtësinë e shqiptimit. Baza për emërtimin e një përbërje kimike është përmbajtja dhe struktura e përbërjes. Për këtë arsye, një term përkrahues që përpiqet të përcaktojë të gjitha elementet e një përbërjeje kimike mund të jetë shpesh një fjalë e gjatë. Nga ana tjetër, për shkak se të gjitha elementet e fjalëve të përdorura në ndërtimin e termave kimikë në mënyrë të njëtrajtshme i referohen substancave, terminologjia e kimisë është e qëndrueshme dhe homogjene - gjë që nuk ndodh në shumicën e degëve të tjera të shkencës.

Në ditët e sotme shkenca e teknologjia po zhvillohen vrullshëm. Në këto kushte është i domosdoshëm edhe zhvillimi dhe përsosja e terminologjisë shkencore e teknike. Në procesin e pasurimit të leksikut terminologjik me njësi të reja, diferencimi konceptor ndihmon për ta bërë më të qartë e më të përpiktë gjuhën e shkencës dhe të teknikës, gjë që i përgjigjet edhe kërkesës së përhershme për t’u kuptuar e zbatuar sa më mirë nga përdoruesit e gjuhës në përgjithësi dhe nga specialistët në veçanti. Gjendja e sotme e terminologjisë së fushave themelore të dijës dëshmon se në shtresimin bazë të saj është arritur përgjithësisht njëfarë kristalizimi me sistemin e formësimit e koncepteve si rrjedhojë e rrënjës në mikrosistemet terminologjike të njësive gjuhësore të qëndrueshme me bazë shqipe.

Për ndërtimin, sistemin, shqipërimin e standardizimin në mënyrë të veçantë të leksikut të terminologjisë shkencore e teknike, sot kërkohet një punë e thelluar nga specialistët e fushave të ndryshme, gjuhëtarët dhe terminologët. Nga njëra anë, baza e kësaj pune është sistemimi i terminologjisë, mënjanimi i gjendjes shumëformëshe, ku për një koncept përdoren disa terma, dhe, nga ana tjetër, thyerja e shumëkuptimësisë së termave, kur i njëjti term shënon disa koncepte. Realizimi i këtyre qëllimeve lidhet me krijimin e një sistemi terminologjik homogjen, në të cilin çdonjëri nga termat t’i përgjigjet një koncepti të caktuar në sistemin e koncepteve. Për ta bërë sa më të tejdukshëm sistemin e koncepteve nga ana e përmbajtjes kërkohet edhe një qartësi e madhe nga vetë termat. Kjo qartësi dhe saktësi arrihet kur terminologjia e kësaj fushe vihet mbi baza sa më shqipe. Në këtë proces synohet që termi të zgjidhet, të përpunohet e t’i përshtatet mirë konceptit përkatës, dhe që, krahas kësaj, njësitë e reja të ndërtohen drejt sipas strukturës fjalëformuese, duke shfrytëzuar sidomos mënyrat e mjetet më prodhimtare e më aktive të saj në kohën tonë. Problemet e përpunimit të termave të fushave të ndryshme të shkencës e të teknikës prej kohësh kanë tërhequr vëmendjen e terminologëve e të specialistëve të fushave të ndryshme. Mishërimi më i

drejtpërdrejtë e praktik i kësaj pune ka qenë dhe mbetet hartimi i fjalorëve përkatës, të ndërtuar mbi bazën e parimeve të caktuara shkencore e sipas kriterëve të qëndrueshme leksikografike. Gjatë kësaj pune rëndësi e veçantë i është kushtuar dhe i kushtohet edhe studimit të gjendjes reale të çdo terminologjie dhe mundësive potenciale të vetë gjuhës shqipe për t'i përsosur më tej sistemet terminologjike, për t'i ngritur ato në një nivel cilësisht më të lartë.

Në hartimin e fjalorëve të fushave të ndryshme të dijes vëmendja kryesore është përqendruar fillimisht në studimin tërësor të leksikut të gjuhës së sotme shqipe, duke e parë atë nga dy këndvështrime: nga pikëpamja e brumit të gatshëm, pra, nga mundësitë dhe aftësitë e fjalëve ekzistuese për t'u ngritur në terma, si edhe nga pikëpamja e gjedheve fjalëformuese së bashku me brumin leksikor prodhues. Kështu nga njëra anë, janë marrë si material i gatshëm, i përshtatur, fjalë të ngritura në terma, dhe nga ana tjetër, janë ndërtuar terma të rinj mbi bazën e gjedheve fjalëformuese, në vend të termit të huaj. Por edhe pse janë bërë përpjekje për zëvendësimin e termave me burim grek me terma në shqipe, termat burim nga greqishtja nuk kanë dalë nga përdorimi. Për shembull termat *kardiolog* dhe *pediatër* kanë gjeçësitë e tyre në shqip *mjek i zemrës* dhe *mjek i fëmijëve*. Në ligjërimin e përgjithshëm më së shumti përdoret *mjek i zemrës*, ndërsa në një ligjërim të specializuar përdoret termi *kardiolog*, *pediatër* etj. Nëse në shqipe mund të themi *mjek i zemrës* në vend të *kardiolog*, vështirë të themi *degë e mjekësisë që studion zemrën dhe sëmundjet e saj*, kur fare shkurt e bukur mund të themi *kardiologji*, apo të themi *degë e mjekësisë që merret me sëmundjet e fëmijëve dhe me mjekimin e tyre* për termin njëfjalësh *pediatri*. Kjo ka të bëjë me problemet që lidhen me përpikërinë e shprehjes së koncepteve nga termat përkatës. Disa argumente që do të japim më poshtë shpjegojnë se përse greqishtja ka ushqyer dhe vazhdon të ushqejë në shkallë kaq të gjerë gjuhët ndërkombëtare dhe në veçanti terminologjinë shkencore:

1. GREQISHTJA ËSHTË SHPREHËSE E KONCEPTEVE GJUHËSORE

Grekët e lashtë mund të mos ishin të parët në dije, por ishin ata që e organizuan dijen dhe e ngritën në profesion. Dhe, mbi të gjitha, ata e shkëputën shkencën nga zotërimi religjios i saj. Grekët e lashtë ndoshta nuk ishin themeluesit e shkencës dhe teknologjisë, por ata kanë kontribuar më shumë në dije dhe përparim në ato fusha sesa kushdo në kohët moderne. Hipokrati (shek. V para Krishit) dhe Galeni (shek. II pas Krishit), që ishin themeluesit e mjekësisë perëndimore e zgjodhën greqishten si gjuhën e parapëlqyer të kësaj shkence. Studimi historik i disa degëve të shkencës na njehtë me idetë dhe teoritë që ishin shprehur në gjuhët greke dhe romake. Në fakt, nomenklatura e përdorur në disa shkencë mund të thuhet me të drejtë se përbën mishërimin e historisë së tyre. Për këto arsye, dhe jo vetëm, balanca e favorshme në nomenklaturën shkencore zgjatet natyrshëm tek gjuha greke, sepse ajo plotëson të gjitha nevojat për shprehje të një niveli të lartë shpirtëror e shkencor, dhe mundëson shpjegimin e të gjitha kuptimeve më abstrakte të çdo fjale. Nga aspekti kuptimor greqishtja është gjuhë e fuqishme, me mundësi të rralla polisemie dhe ngjyrimë kuptimorë, dhe nga aspekti shprehës është gjuhë e saktë.

2. GREQISHTJA KA SAKTËSI KUPTIMI DHE QËNDRUESHMËRI

Një term i mirë shkencor është ai që përdoret lehtësisht në situata normale dhe që gëzon ose kërkon lehtësisht miratim të përgjithshëm duke u përshtatur shpejt në shoqërinë e fjalëve që kanë lidhje të ngushtë me të në përdorimin e gjerë. Për sa kohë greqishtja e vjetër nuk përdoret më si gjuhë bashkëbiseduese, kuptimet e fjalëve në këtë gjuhë janë rrënjësorë dhe janë bërë të qëndrueshme. Termat grekë nuk janë më subjekt i ndryshimeve morfologjike dhe semantike, të cilat prekin termat e gjuhëve aktualisht të folura. Për këtë arsye, një term shkencor i ndërtuar nga elementë të marrë nga fjalë kuptimi dhe forma e të cilave kanë qenë stabilizuar, do të ketë detyrimisht të njëjtën cilësi stabiliteti gjeçës. Saktësia e kuptimit dhe qëndrueshmëria janë cilësi shumë të dëshirueshme të termave të përdorur në fusha gjithëpërfshirëse dhe me ndërlidhshmëri në rritje.

3. NJËSITË NDËRTIMORE TË TERMAVE ME BURIM NGA GREQISHTJA KANË KUPTIME TË NGULITURA DHE TË SAKTA

Gjithashtu, kuptimet dhe tonet me ngarkesë emocionale shpesh hyjnë në fjalë të marra nga gjuhë aktualisht të folura, prandaj është detyrimisht e nevojshme që të përdoren terma të tillë, njësitë ndërtimore të të cilëve kanë kuptime të ngulitura dhe të sakta. Në greqishten e lashtë, një shkencëtar mund të gjejë elemente fjalësh që i mundësojnë atij të krijojë terma, të cilat përmbushin saktësisht nevojat e tij dhe që do ta ruajë në vazhdimësi saktësinë e kuptimit dhe të formës. Përdorimi i termave specifike është një cilësi e dëshiruar për terma teknike në çdo fushë shkencore, në mënyrë që të mos ketë asnjë mundësi për keqkuptime. Zakonisht një term i ndërtuar nga elemente që e kanë prejardhjen nga një gjuhë e vetme është më i parapëlqyer se një term hibrid, i cili kombinon elemente që e kanë prejardhjen nga më shumë se një gjuhë. Elementet ndërtues të prejardhur nga një gjuhë zakonisht kombinohen më lehtë dhe në mënyrë më eufonike sesa elementët e marra nga gjuhë të ndryshme.

4. NATYRA SINTETIKE E GREQISHTES FAVORIZON KRIJIMIN E TERMAVE QË TINGËLLOJNË BUKUR

Greqishtja është gjuhë sintetike me përshtatshmëri të lartë. Kjo natyrë ose karakteristika ngulitëse e gjuhës greke e bën këtë gjuhë veçanërisht të përshtatshme për përdorim në formimin e termave të përbërë ekonomikë, përshkrues dhe atyre që tingëllojnë bukur. Një ose më shumë rrënjë, parashtesa dhe prapashtesa greke mund të sintetizohet në një term të vetëm që do t'i furnizojë të dyja, emrin dhe përkufizimin, dhe përsëri të mos tingëllojë i ashpër, artificial apo i ngathët. Është karakteristikë e termave grekë të jenë të përbërë nga rrënjë, tema, parashtesa dhe prapashtesa. Për shembull, termi 'nefrolit' (*gr.* νεφρός - veshkë + λίθος - gur) është i shkurtër, i qartë dhe tingëllon bukur. Lehtësisht me këtë term krijohet një term tjetër, 'nefrolitotomi', duke i shtuar një element tjetër (τομή - çarje, prerje) pa e dëmtuar cilësinë e tij. Termet e rinj të krijuar në të njëjtën mënyrë nga elementet grekë mund të adaptohen me kërkesat moderne dhe prapëseprapë të mos ngjajnë as të ashpra dhe as artificiale. Në përgjithësi, është e vështirë dhe thuajse e pamundur të përcaktosh nga struktura e një termi teknik, nëse është fjalë që ka qenë përdorur nga grekët apo romakët në përdorimin e përditshëm apo është fjalë që është sajuar në kohët moderne. Sinteza e një sërë elementesh përshkruese, kaq e dëshiruar dhe pothuajse e domosdoshme në fjalorin e një shkence ekzakte dhe komplekse, lehtësohet jashtë mase nga përdorimi i gjuhëve që në vetvete janë sintetike dhe elastike për nga natyra.

5. GREQISHTJA SHKENCORE ËSHTË E KUPTUESHME NË SHUMË GJUHË TË BOTËS

Greqishtja, për sa i përket lëmit të terminologjisë, është gjuhë ndërkombëtare. Në thuajse çdo pjesë të botës ka njerëz të arsimuar që kanë njohuri të gjuhës greke. Në shumë vende të botës, edhe në ditët e sotme greqishtja mësohet si gjuhë e dytë nëpër shkolla dhe universitete. Universaliteti i greqishtes provohet edhe nga fakti se një material i një fushe shkencore në një gjuhë të huaj mund të lexohet më me lehtësi sesa një material tjetër në të njëjtën gjuhë që flet për një temë të përgjithshme. Arsyeja për këtë është se shumë fjalë të përdorura nga shkencëtarët në vende të ndryshme të botës kanë një burim të përbashkët, greqishten. Terminologjia shkencore ka karakter të theksuar ndërkombëtar, aq sa disa pretendojnë se ajo është aq afër të qenurit një gjuhë pothuajse ndërkombëtare.

6. TERMAT ME BURIM NGA GREQISHTJA PËRÇOJNË KUDO TË NJËJTAT KUPTIME

Përdorimi i gjerë dhe i vazhdueshëm i greqishtes si burimi kryesor për krijimin e termave teknikë ka ngritur, ka përforcuar dhe ka themeluar në nomenklaturën e shkencave kryesore një kohezion dhe unitet të paarritshëm. Kështu, një fushë shkencore moderne, duke ndërtuar terminologjinë e saj me bazë greqishten, mund t'i lejojë vetes të jetë aleate e frytshme me fushat e tjera shkencore. Për shembull, nëse disa mjekë nga vende të ndryshme të botës, pavarësisht nga mosnjohja e gjuhëve të njëri-tjetrit, do të flisnin për një temë mjekësore me terma shkencorë me burim nga greqishtja, ata do të arrinin të kuptoheshin shumë mirë midis tyre.

Arsyet e përmendura më lart shpjegojnë përse greqishtja ka qenë dhe është themeli mbi të cilën janë ndërtuar termat shkencorë. Zgjedhja e kësaj gjuhë të lashtë nuk ishte e rastësishme, por kishte arsyt e saj historike dhe përparësi praktike të caktuara, të cilat pritej të shtoheshin nga përdorimi i një burimi gjuhësor të përbashkët që kishte një fjalor të shumëllojshëm, gjithëpërfshirës me terma që ishin elastikë në formë por edhe të qëndrueshëm në kuptime. Një fjalor shkencor me burim gjuhësor nga greqishtja, u jep shkencëtarëve sigurinë se termat e tyre teknikë do përçojnë kudo të njëjtat kuptime.

7. TERMAT GREKË JANË TË MIRRORIENTUAR NË FUSHAT SHKENCORE

Një term është i mirorientuar nëse shfaq lehtë lidhjet dhe marrëdhëniet e tij me koncepte të tjera në fushën e tij personale dhe në fusha të tjera të lidhura ngushtë me të. Në nomenklaturën binome dhe trinome të shkencave biologjike, orientimi i mirë arrihet nga përdorimi i shënjesve dy-trifjalëshe të kafshëve dhe të bimëve. Megjithatë, për shkak se orientimi dhe klasifikimi janë kaq të rëndësishëm për nomenklaturën e këtyre fushave, ekziston njëfarë rreziku që i kushtohet shumë pak vëmendje faktorëve të tjerë të rëndësishëm në procesin e emërimit, siç janë struktura, procesi, cilësia dhe procedura. Me anë të përdorimit të kujdesshëm të një fjale në një ose më shumë elemente përbërëse përdorur në terma të tjerë që kanë lidhje me të, do të tregohet marrëdhënia midis disa fjalësh si dhe rëndësia e secilës prej tyre. Orientimi i mirë i termave në fusha shkencore kërkon gjithashtu edhe vëzhgim të kujdesshëm të terminologjisë së përdorur në degë të shkencës së afërt, në mënyrë të tillë që fjalë të përbashkëta në të dyja fushat të mund të harmonizohen në formë dhe në kuptim.

8. KORREKTËSIA GJUHËSORE

Një term i mirë shkencor përshtatet si në strukturë ashtu edhe në formë me përdorimin më të mirë gjuhësor. Për të ndërtuar termin, vëmendje e veçantë duhet pasur në sigurimin dhe përdorimin korrekt të rrënjës, bazës, parashtesës, prapashtesës, zanoreve kombinuere, kohëve, formave zgjedhore duke iu referuar fjalëve bazë nga të cilat e kanë

prejardhjen shumë elemente të termave teknike dhe duke vëzhguar rregullat e transliterimit. Termat dhe variantet e keqformuara në drejtshkrimin e tyre shkaktojnë mërzitje dhe vështirësi të panevojshme. Për shembull termat *adenemë*, *dermalaksi*, *megastri*, kanë korrektësi më të madhe gjuhësore sesa variantet e tyre të gjatë dhe të keqformuar: *adenonemë*, *dermamalaksi*, *megagastri*.

Nga krijuesit e termave shkencore ndonjëherë pritet që ata të shpjegojnë etimologjinë e termave të tyre. Kjo është një praktikë e mirë, sepse jo vetëm që zvogëlon gabimet në ndërtimin e fjalës por edhe përmirëson cilësinë e termave të zgjedhur. Fjalorët më të mirë shkencorë japin termat nga të cilat e kanë prejardhjen termat teknike zakonisht në alfabetin dhe shqiptimin origjinal.

9. EKONOMIA DHE LEHTËSIA FUNKSIONALE

Termtat që nuk i binden shqiptimit nuk duhen përdorur, me përjashtim të rasteve kur janë tepër të nevojshme. Terma si pneumoultramikroskopiksilikovolkanokoniozë dhe hepatikokolangiolcolcistentkrozotomi nuk janë terma ekonomikë dhe as përdoren lehtësisht. Megjithatë, një term si laingoltrakeobronkitis mund të përligjet pavarësisht nga gjatësia e tij, sepse përshkruan fusha të infeksionit edhe pse shqiptimi është shumë i vështirë. Një term i mirë shkencor është ai që përdoret lehtësisht në situata normale dhe që gëzon ose kërkon lehtësisht miratim të përgjithshëm duke u përshtatur shpejt në shoqërinë e fjalëve që kanë lidhje të ngushtë me të në përdorimin e gjerë. Grada në të cilën fjalët e ndryshme përbajnë lehtësi funksionale dhe përshtatshmëri shpesh mund të jetë ndihmuese për të bërë zgjedhje mes termave sinonimë. Për shembull, në bazë të lehtësisë funksionale helmintologji do të parapëlqehet ndaj odontologji ose stomatologji, megjithëse stomatologji mund të përshkruajë qëllimin e profesionit dental më mirë se dentistrin ose se odontologjinë. Sigurisht që nuk duhet të merret në konsideratë vetëm lehtësia funksionale në bërjen e zgjedhjeve përfundimtare mes termave sinonime; kriteret e tjera të termave të mira shkencore duhen marrë po ashtu në konsideratë. Për të arritur lehtësi funksionale një term teknik duhet të plotësojë kriteret e veçanta në fushën në të cilën termi do të përdoret kryesisht. Kodi zyrtar i nomenklaturës në fushën shkencore mund të jetë një ndihmë e vlefshme në përcaktimin e kriterëve speciale.

10. QËNDRUESHMËRIA

Kur përkufizohet, një fjale nuk i duhen dhënë pa arsye të fortë kuptime të reja apo kuptime shtesë, dhe nuk duhet ndryshuar as shqiptimi. Për sa kohë që termat teknikë në përgjithësi nuk janë të besueshëm që nuk ruajnë formën dhe kuptimin e tyre specifik, do të ketë shumë pësjtjellim dhe pasiguri në terminologji. Me qëllim që të ruhet forma dhe kuptimi i termave teknikë, i ashtuquajtur 'ligji i përparësisë' është futur në fuqi në disa fusha shkencore. Pavarësisht nga dëshira e ruajtjes të pandryshuar të termave, është e domosdoshme një shkallë e caktuar rafinimi e termave ekzistues, sidomos në rastet kur fjalë të keqzgjedhura kanë hyrë në fjalor. Shkencëtarët kanë kuptuar që rrethanat e ndryshuara dhe zbulime të reja i detyrojnë disa fjalë të ndryshojnë kuptimin, edhe pse format e fjalëve nuk ndryshojnë (p.sh. atom dhe elektron). Kjo ndodh pjesërisht për shkak të ndërjegjeshmërisë së këtyre fakteve që organizata shkencore ngrenë komisione për nomenklaturat dhe kërkojnë rishikime periodike të fjalorëve.

REFERENCA

- Babinioti, J., (2015). *Ελληνική γλώσσα - παρελθον, παρον, μελλον* (Gjuha greke - e shkuara, e tashmja, e ardhmja). To Vima.
- Babinioti, J., (2016). *Λεξικό των Παραγώγων και Συνθέτων* (Fjalor i derivateve dhe i kompozitave). Ianos.
- Babinioti, J., (2014). *Λεξικό των Δυσκολιών και των Λαθών* (Fjalor i vështirësive dhe i gabimeve). Ianos.
- Babinioti, J., (2015). *Λεξικό των πιο απαιτητικών λέξεων* (Fjalor i fjalëve më të kërkuara). To Vima.
- Babinioti, J., (2016) *Λεξικό των Παραγώγων και Συνθέτων* (Fjalor të derivateve dhe kompozitave). To Vima.
- Bakillari, V., (2017) *Thërrmijëza gjuhësore / Vëzhgime dhe hulumtime në gjuhën shqipe*. Mîrgeeralb.
- Çabej, E., (1976). *Huazimet greke te Marrëdhëniet e shqipes në periodën e saj historike në Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*, në Studime gjuhësore III.
- Nybakken, O. E., (1979) *Greek and latin in scientific terminology*. The Iowa State University Press.
- Duro, A., (2007). *Termi dhe fjala në gjuhën shqipe*.
- Rrokaj, S., (2007) *Huazimet në gjuhën shqipe*, në *Çështje të gjuhës shqipe*, Tiranë.
- Silk, M., (2016). *Standard Languages and Language Standards*, Centre for Ellenic Studies, King's College.
- Wiley-Blackwell (2014) *A Companion to the Ancient Greek Language*.